



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.56-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura në 28 dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 31.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

I.KORRIGJOHET rreshti i parë në pikën III të dispozitivit të vendimit ZP.Anr.56/2025 i datës 30.12.2025 ashtu që në vend të: Detyrohet Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), duhet të jetë: Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

II.Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.

III. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit ZP.Anr.56/2025, i datës 30.12.2025.

A r s y e t i m

PZAP-i duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga Subjekti Politik AAK, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me vendimin nr. ZP.56/2025 të datës 29.12.2025, e ka pranuar si të bazuar ankesën e subjektit politik AAK, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të vendimit. Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), pas pranimit të këtij vendimi përmes e-mailit të dorëzuar në PZAP me datë 30.12.2025, ka kërkuar nga PZAP që të behët korrigjimi i gabimit teknik në pikën III të dispozitivit të vendimit, ashtu që në vend të Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), duhet të jetë Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Paneli duke vepruar sipas kërkesës së palës ankuese të subjektit politik AAK vlerëson se gjatë përpilimit të vendimit ZP.Anr.56/2025, i datës 30.12.2025, në rreshtin e parë të pikës III të dispozitivit të vendimit gabimisht është shënuar Detyrohet Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, e që duhet të jetë: Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, që gjobën e shqiptuar si

në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Andaj duke ju referuar të cekurave më lart dhe duke u mbështetur në nenin 50 të Ligjit Nr.05L-031 të LPPA-së, Paneli erdhi në përfundim se duhet bërë korrigjimi i vendimit të lartcekur, për arsye se është vërtetuar se gjatë përpilimit të vendimit është bërë gabim teknik në rreshtin e parë të pikës III të dispozitivit të vendimit ZP.56/2025 të datës 30.12.2025.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.56-2/2025, datë 31.12.2025

Kryesuese e Panelit,
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 4 i LZP-së.